



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE:16

SPRING 2022



About the Journal

Beder Journal of Humanities (BJH) is a peer-reviewed journal published by University College "Bedër" High Education Institution (HEI), Faculty of Humanities and Law. The main objective of BJH is provide international scholars an intellectual platform for the exchange of contemporary research

The journal publishes research papers in the fields of Humanities such as Law, Theology, Communications, Spirituality, Economy and Religion, Morality, History, International Relations, Political Science, Public Relation, Marketing, Human Rights and Sociology, Education and Literature. From 2013, Beder Journal of Humanities (BJH) became a scholarly blind peer-reviewed publication, with an Editorial Board and International Advisory Board comprised of eminent scholars in Balkan, Europe and beyond.

EDITOR-IN-CHIEF

Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi, University College Bedër, Albania.

ASSISTANT EDITORS

PhD Edona Llukaçaj, University College Beder, Albania
PhD Valmora Gogo, University College Beder, Albania
PhD Nertil Bërdufi, University College Beder, Albania
PhD Suela Musta

EDITORIAL BOARD

Prof. Dr. Altin Shegani, Tirana University, Albania
Prof. Dr. Ardian Nuni, Tirana University, Albania
Prof. Dr. Ayhan Tekineş, Vienna University, Austria
Prof. Dr. Briseida Mema, Tirana University, Albania
Prof. Dr. Ferit Duka, UET, Albania.
Prof. Dr. Hajri Shehu, University of Tirana, Albania
Prof. Dr. Rami Memushaj, University of Tirana, Albania
Akad. Fejzi Kolaneci, Akademician
Assoc. Prof. Dr. Mark Marku, University of Tirana, Albania
Assoc. Prof. Dr. Selami Xhepa, European University of Tirana, Albania
PhD Enriketa Sogutlu, University College Beder
PhD Ana Uka, University College Beder, Albania
PhD Atakan Derelioglu, University College Beder, Albania
PhD Bojana Hajdini, University College Beder, Albania
PhD Erlis Çela, University College Beder, Albania
PhD Ferdinand Xhaferaj, University College Beder, Albania
PhD Genti Kruja, University College Beder, Albania
PhD Ilirjana Kaceli, "Aleksandër Xhuvani" University of Elbasan, Albania
PhD Irvin Faniko, The Security Academy, Tirana, Albania

PhD Isa Erbaş, University College Beder, Albania
PhD Jamal Alsafarti, University College Beder, Albania
PhD Ndriçim Ciroka, University College Beder, Albania
PhD Ramadan Cipuri, University of Tirana, Albania
PhD Sadullah Yılmaz, University College Beder, Albania

INTERNATIONAL ADVISORY BOARD

Prof. Dr. Abdullah Hamiti, University of Pristina, Kosovo
Prof. Dr. Admiel Kosman, Potsdam University, Germany
Prof. Dr. Francesco Zannini, Pontificio Istituto di Studi Arabi e d'Islamistica, Italy.
Prof. Dr. Hamit Xhaferri, Universiteti UEJ, Tetovo, North Macedonia
Prof. Dr. Hans Köchler, Innsbruck University, Austria
Prof. Dr. İsmail Albayrak, Australian Catholic University, Australia
Prof. Dr. John Esposito, Georgetown University, Washington, USA
Prof. Dr. Jon Pahl, Lutheran Theological Seminary, USA
Prof. Dr. Kerima Filan, Sarajevo University, Bosnia & Hercegovina
Prof. Dr. Mark Webb, Texas Tech. University, USA
Prof. Dr. Paul Weller, University of Derby, U.K.
Prof. Dr. Qazim Qazimi, University of Pristina, Kosovo.
Prof. Dr. Recep Ileri, Universitate Europei de Sud-Est
Prof. Dr. Sebastiano Tafaro, Bari University, Italy
Akad. Feti Mehdiu, Pristina, Kosovo
Assoc. Prof. Dr. Ahmet Ecirli, Institute of Sociology, Academia Romana, Romania
Assoc. Prof. Dr. Laura Tafaro, Bari University, Italy
Prof.
Assoc. Prof. Dr. Zeki Sarıtoprak, John Carroll University, USA.



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE:16
SPRING 2022

Publication Frequency: Biannual

ISSN: 2306-6083

ISSN Online: 2707-3041

Tirana, Albania

www.bjh.beder.edu.al

TABLE OF CONTENTS

Alban TUFA

Mediet e reja, kapitalizmi, algoritmet dhe iluzioni demokratik.....	1
--	---

Erisa DATJA

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike.....	17
--	----

Fioralba MARKJA

Ndikimi i pandemisë Covid-19 mbi të drejtat e njeriut.....	30
--	----

Genti KRUJA

Interfaith Dialogue in Albania as a Model of Interreligious Harmony.....	46
---	----

Edona LLUKACAJ

‘Twilight’ Multiculturalism: Kadare’s Conceptualization of Pan-albanian identity in the age of Multiculturalism	68
---	----

Armina MACIĆ , Ceylani AKAY

‘An analysis of the representation of cultural content in reading texts in Headway ELT textbook’	87
---	----

Suela MUSTA

Mediatizimi i Covid-19 dhe sfida e lajmeve të rreme në vitet 2020-2021	106
---	-----

Alban TUFA ¹

Mediet e reja, kapitalizmi, algoritmet dhe iluzioni demokratik

Abstrakt

Mediat e reja kanë sjellë alternativa të tjera në procesin e komunikimit dhe të informimit, duke u konsideruar prej studiuesve si media që kanë demokratizuar informacionin. Po ashtu këto media kanë përmbysur skemën e komunikimit, duke thyer barrierat, duke lindur nevojën për rithemelim të koncepteve si dhe duke ndryshuar mënyrat e të bërit gazetari apo marketing. Nga kjo pikëpamje, punimi analizon rolin që luajnë tashmë mediat e reja në kapitalizëm dhe rolin e tyre në përsosjen e demokracisë apo pengimin e zhvillimit të saj.

Në shkencat sociale, dhe sidomos në shkencat politike, studiuesit kanë ngritur teori të ndryshme mbi demokracinë dhe apekset që lidhen me të. Madje disa prej tyre flasin edhe për iluzionin demokratik, ku në këtë pretendim një rol të rëndësishëm kanë edhe mediat e reja.

Në një dimension tjetër, punimi trajton diferencën mes demokracisë dhe iluzionit demokratik. Edhe pse në botë panorama mediatike mbizotërohet nga mediat e reja dhe ato digjitale, prej vitesh shumë studime janë fokusuar në zhvillimin dhe rolin algoritmeve si ndikues sa në zhvillimin e kapitalizmit aq dhe në pengimin e demokracisë. Në pjesën e fundme, punimi trajton rolin që luajnë algoritmet në manipulimin e përdoruesve të mediave të reja.

Fjalët kyçe: *mediat e reja, mediat sociale, kapitalizmi, algoritmet, demokracia*

¹ Kolegji Universitar “Bedër”
Departamenti i Shkencave të Komunikimit,
Email:
azaimi@beder.edu.al

Abstract

New media have brought other alternatives to the communication and information process, being considered by scholars as media that have democratized information. These media have also overturned the communication scheme, breaking down barriers, creating the need for re-establishing concepts and changing the ways of doing journalism or marketing. From this point of view, the paper analyzes the role that the new media already play in capitalism and their role in perfecting democracy or hindering its development.

In the social sciences, and especially in the political sciences, scholars have developed various theories on democracy and the apexes associated with it. Some of them even talk about the democratic illusion, where the new media have an important role in this claim.

In another dimension, the paper addresses the difference between democracy and democratic illusion. Although the media landscape in the world is dominated by new and digital media, for years many studies have focused on the development and role of algorithms as influential in both the development of capitalism and the obstruction of democracy. In the final part, the paper addresses the role that algorithms play in manipulating new media users.

Keywords: *new media, social media, capitalism, algorithms, democracy*

Hyrje

Shembja e sistemeve komuniste në Europën Lindore dhe në Shqipëri, paralelisht me pluralizmin politik solli edhe pluralizmin e mjeteve të informimit, duke shtuar mediat private si edhe një logjikë të re funksionimi të sistemeve të informimit. Nga ana tjetër, kapitalizmi solli një treg mediatik duke iu shtuar në mënyrë të pandashme edhe tregu i reklamave apo i shfrytëzimit të hapësirave mediatike. Po ashtu demokratizimi i medias i dha asaj veç rolit informues edhe rolin monitorues apo kontrollues të pushtetit, duke marrë një peshë vendimtare në konsolidimin e demokracisë. Megjithatë, për të ndërtuar një ide të qartë për sistemet kapitaliste, duhet njohja në thelb e sistemeve komuniste, ose thënë ndryshe, sistemeve totalitare. Në kapitullin e parë të librit “Komunizmi, Kapitalizmi dhe Massmedia” Colin Sparks, shpjegon me imtësi raportet mes medias dhe totalitarizmi, mënyrat se si media përdorej në kohën e diktaturës, dhe se si garantohej monopoli i burimit të informacionit, i cili ishte i gjithi zyrtar dhe pa alternativë (Sparks, 1998). Kur Sparks shpjegon konceptin e totalitarizmit, citon Brezinskin ku thotë se “totalitarizmi është një sistem ku instrumentet teknologjik të përparuara të pushtetit politik, janë plotësisht në dorë të një lidërshipi të centralizuar për të bërë një revolucion shoqëror total, duke e kushtëzuar njeriut mbi bazën e disa hamendjeve ideologjike arbitrare të shpallura nga lidërshipi, në një atmosferë unanime të detyrueshme, për gjithë popullin”. (Sparks, 1998) Nga kjo pikëpamje, mediat shërbyen për të riformuluar shoqërinë, gjë e cila në njëfarë mase mund të vlejë edhe në sistemet demokratike. Në sistemet demokratike, media përdoret nga lidërshipi, për të përçuar mesazhet, për të propaganduar, gjë e cila është deri diku e pranueshme. Megjithatë, sipas studiuesve mediat janë parë edhe si zhvilluese të debatit publik si dhe faktorë të rëndësishëm të zhvillimit të demokracisë. (Habermas, 1989)

Zhvillimet teknologjike sollën edhe zhvillime të reja në aspektin e komunikimit, sidomos me zhvillimin e mediave të reja, duke konkurruar mediat tradicionale dhe duke shtuar kanalet e komunikimit. Por nga ana tjetër, po këto media me hovin e

zhvillimit teknologjik, rritën edhe mundësinë e manipulimit të audiencave, për qëllime apo interesa të ndryshme. (Lingren, 2017)

Studiuesit mediave të reja dhe mediave sociale trajtojnë rolin që luajnë ato në diskursin publik. Sipas tyre këto media ndihmojnë në ndryshimin e narrativës publike si dhe kanë një rëndësi të madhe në modelimin e opinionin publik. Tipik është rasti i zgjedhjes së Donald Trump president ku duke shfrytëzuar platformën Facebook, nëpërmjet *trolleve* (llogarive të rreme) u ndryshua e gjithë narrativa e opinionit publik në hapësirën digjitale. (Sullivan, 2019)

Metodologjia

Ky punim është trajtuar në formën e rishikimit të literaturës, duke u bazuar në autorë dhe studiues të komunikimit dhe politikës, punimet e të cilëve lidhen me të shkuarën dhe ndikimi e saj në sistemin e sotëm shoqëror, qeverisës dhe me modelin mbizotërues të medias. Përgjatë punim janë përdorur të dhëna cilësore dytësore, bazuar në koncepte dhe këndvështrime teorike mbi të cilat janë ndërtuar plot modele komunikimi dhe interpretime që studiuesit ju kanë bërë këtyre koncepteve teorike. Fillimisht, përgjatë punimit analizohet marrëdhënia mes medias dhe propagandës, si elementë thelbësor në zhvillimin apo pengimin e zhvillimit të një demokracie. Këto analiza fokusohen në punën e studiuesit dhe kritikut të medias Christian Fuchs. Pastaj punimi fokusohet në kornizën e Teoria së varësisë së sistemit mediatik (MSD), ose thjesht varësisë nga media, e zhvilluar nga teoricienët e sociologjisë së komunikimit Sandra Ball-Rokeach dhe Melvin Defleur.

Në fund, punimi trajton rolin që luajnë mediat e reja, duke ndjekur praktikën e tyre algoritmike duke ndikuar në mënyrë thelbësore në krijimin e një iluzioni mbi demokracinë.

Hipoteza dhe pyetje kërkimore

Pasi është bërë një rishikim i detajuar i literaturës dhe modeleve të ndryshme teorike është ngritur hipoteza si vijon: *Duke parë zhvillimet socio-politike dhe duke ndjekur praktikat algoritmike mediat e reja po luajnë një rol të rëndësishëm, në zhvillimin e një iluzioni mbi demokracinë. Kjo bëhet duke tentuar manipulimin e audiencave nëpërmjet filtrimit të informacionit, mbinxitjes dhe mikro-shënjestrimit.*

Për t'i ardhur në ndihmë punimit dhe për të vërtetuar hipotezën janë ngritur disa pyetje kërkimore:

- *Çfarë raporti kanë mediat e reja me kapitalizmin dhe demokracinë?*
- *Cilat janë praktikat që ndjek media në përmbushjen e iluzionit demokratik?*
- *Çfarë roli kanë algoritmet në zhvillimin e demokracisë dhe si veprojnë ato në ndërtimin e flluskave të filtrit?*

Mediat, propaganda dhe teoria e varësisë së sistemit mediatic

Një ndër rolet dhe funksionet medias është rolin i saj edukues, sidomos kur bëhet fjalë për edukimin politik dhe rolin e saj në informimin e audiencës së angazhuar dhe qytetare. Sipas studiuesit të medias dhe komunikimit David Beers, media ka rëndësi për edukimin në dy mënyra. Së pari si një hapësirë në të cilën qytetarët mësojnë, dallojnë, debatojnë dhe gjykojnë për të formuluar veprimet, kështu mediat informative mund të imagjinohet si njëfarë zgjatimi i shkollës. Dhe, së dyti si një forcë e fuqishme në shoqërinë demokratike për nxitur ndryshimin ose për ta kundërshtuar atë. Kështu mediat informative duke u parë si subjekte mund të garantojnë fokusin kritik. (Beers, 2006)

Në një pikëpamje tjetër, krejtësisht kritike, komplet të kundërt me Beers-in, kritiku dhe studiuesi i mediave Cristian Fuchs, e sheh median në ditët e sotme si një mjet gjigand propagande. Ai shprehet se mediat janë grupe filtrimi lajmesh dhe shpjegojnë përbërësit thelbësorë të modelit të propagandës. Pikëpamjet e tij mbi rolin që ka media në shoqëritë kapitaliste, kanë qenë në shumicën e rasteve kritike. Sipas Fuchs, përbërësit thelbësorë të modelit të propagandës, ose grupeve të “filtrave” të lajmeve, renditen si më poshtë:

1. *Madhësia, pronësia e përqendruar, pasuria e pronarit dhe orientimi i fitimit të kompanive mbizotëruese të mediave masive;*
2. *Reklamimi si burimi kryesor i të ardhurave të masmedias;*
3. *Besimi i mediave në informacionin e dhënë nga qeveria, biznesi dhe 'ekspertët' të financiar dhe aprovuar nga këto burime parësore dhe agjentë të pushtetit;*
4. *"Arma" si një mjet për të disiplinuar median; dhe*
5. *"Antikomunizmi" si një mekanizëm kombëtar feje dhe kontrolli.*

Këta elementë ndërveprojnë dhe forcojnë njëri-tjetrin. Lënda e parë e lajmeve duhet të kalojë nëpër filtra të njëpasnjëshëm, duke lënë vetëm mbetjet e pastruara të përshtatshme për t'u publikuar. Ata rregullojnë ambientet e ligjërimit dhe interpretimit, dhe përkufizimin e asaj që është fillimisht e vlefshme. Sipas Fuchs ligjërimet e vlefshme shpjegojnë bazën dhe veprimet e asaj sasi për fushatat propagandistike. (Fuchs, 2018)

Teoria e varësisë së sistemit mediatik (Media System Dependence Theory), ose thjesht varësia nga media, u zhvillua nga studiuesit e sociologjisë dhe medias Sandra Ball-Rokeach dhe Melvin Defleur në 1976. (Luo, 2018) Duke u bazuar në një pikëpamje sociologjike, teoria pohon se mediat dhe audienca e tyre duhet të studiohen në kontekstin e sistemeve më të mëdha shoqërore. Kjo për arsye sepse media dhe audienca nuk mund të analizohen si të shkëputura nga sfera të tjera të jetës. Nëpërmjet kësaj pikëpamjeje teorike arrihen ndërlidhjet e sistemeve të gjera shoqërore, masmedias dhe individit në një shpjegim gjithëpërfshirës të efekteve mediatike. Megjithatë, shtrati i kësaj teorie gjendet te tradita e efekteve të medias e zhvilluar përgjatë viteve '30-'40, me konceptet e propagandës, të tilla si "fisheku magjik" apo "gjilpëra hipodermike". Sipas këtij këndvështrimi teorik, sa më shumë që një person të varet te media për të përmbushur nevojat, aq më e rëndësishme do të jetë media në jetën e atij personi dhe për rrjedhojë aq më shumë efekte do të ketë media tek ai person. (Luo, 2018) Megjithatë, në një pikëpamje tjetër, ky këndvështrim teorik lidhet ngushtë edhe me pikëpamjet e përdorimeve dhe kënaqësisë, ngaqë audiencat iu qasen mediave për të përmbushur disa nevoja, të tilla si informimi apo argëtimi.

Në punimin e tyre themelor “*Modeli i varësisë së efekteve të medias*” (A dependency model of mass-media effects), shprehen se natyra e marrëdhënies trepalëshe audiencë-media-shoqëri është ajo që përcakton drejtpërdrejt shumë nga efektet që media ka tek njerëzit dhe shoqëria. (Ball-Rockeach & DeFleur, 1976). Sipas tyre media, audienca dhe shoqëria janë të pandashme nga njëra-tjetra, kjo për arsye sepse ky trekëndësh e jep e merr duke ndryshuar vetveten dhe tjetrin. “Ndërkohë që ka një sërë aspektesh të marrëdhënieve audiencë-media-shoqëri që mund të diskutohen, ai mbi të cilin fokusohemi fillimisht është niveli i lartë i varësisë së audiencës nga burimet e informacionit të masmedias në shoqëritë urbane-industriale.” Sipas Ball-Rockeach & DeFleur në shoqëritë masive të industrializuara njerëzit kanë krijuar varësi nga informacini, dhe kjo bën që të krijojnë varësi edhe nga media, si burim kryesor i informacionit. Për këtë arsye ata në punimin e tyre analizojnë këtë variabël për të kuptuar se kur dhe pse mesazhet mediatike ndryshojnë besimet, ndjenjat ose sjelljen e audiencës. (Ball-Rockeach & DeFleur, 1976)

Në modelin konceptual të Ball-Rokeach dhe Defleur (1976), shoqëria, media dhe audienca ndikojnë njëra-tjetrën dhe nëpërmjet ndërveprimeve, shoqëria dhe media së bashku krijojnë efekte njohëse, afektive dhe të sjelljes tek audienca. (Ball-Rockeach & DeFleur, 1976) Shumë e kanë pranuar dhe aplikuar këtë model teorik duke e kontekstualizuar edhe në situata aktuale të informimit nëpërmjet mediave të reja. “Në rastin e përdorimit të internetit, media i referohet internetit dhe audienca janë përdoruesit e internetit. Interneti është një medium ndërveprues që përdoruesit do të jenë në gjendje të përdorin median për të komunikuar me përdoruesit e tjerë për një sërë qëllimesh; kështu krijon efekte mediatike për përdoruesit” (Luo, 2018). Ashtu siç njerëzit krijojnë e varësi ndaj informacionit në mediat masive tradicionale, ashtu krijojnë varësi edhe ndaj informacioni që buron nga internet. Margaret Meiling Luo e përkufizon varësinë si një marrëdhënie në të cilën plotësimi i nevojave ose arritja e qëllimeve nga njëra palë varet nga burimet e një pale tjetër. Sipas kësaj logjike varësia nga burimet e informacionit mediatik është një kusht i kudondodhur në shoqërinë moderne. “Dikush e gjen këtë gjendje në shumë mjedise,

duke filluar nga nevoja për të bërë blerjet më të mira në supermarket e deri te nevoja më të përgjithshme ose më të përhapura, të tilla si marrja e informacionit që do të ndihmojnë në ruajtjen e një ndjenje të lidhjes dhe familjaritetit me botën shoqërore dhe jashtë saj” (Luo, 2018) Po ashtu, njerëzit duke mbledhur informacion dhe duke krijuar përvoja vetjake dhe të njëpasnjëshme më këtë informacion, i cili në finalen e vet shndërrohet në veprim.

Mediat e reja dhe iluzioni mbi demokracinë

Në këtë periudhë tranzitore gati 30-vjeçare, veç medias tradicionale, hov të madh kanë marrë edhe mediat e reja. Që nga vitet 2010, Facebook filloi të përdorej në mënyrë masive në vendin tonë, pak vite më vonë filloi të përdorej edhe Instagram dhe disa rrjete sociale të ngjashme, duke arritur së fundmi edhe përdorimin në masë të Tik-Tok. Nga ana tjetër njerëzit filluan të informohen nëpër portale dhe audiencat filluan të zhvendoseshin online. Studimet mbi “ueb 2.0” dhe “media sociale” mbizotërohen nga qasjet tekno-përcaktuese që supozojnë se ngritja e këtyre teknologjive rezulton nxit, ose zhvillon një shoqëri më demokratike. Kjo bëhet veçanërisht e qartë kur përfaqësuesit e kësaj qasje flasin për “media sociale pjesëmarrëse” (Fuchs, 2013). Ajo që mungon në të gjitha këto diskutime është një kuptim i bazuar teorikisht i pjesëmarrjes. Ndër studiues përdoren pretendime për implikime për demokracinë, por humbet që në teorinë e demokracisë termi “pjesëmarrje” i cili përdoret kryesisht dhe paraqitet më së shumti në teoritë e demokracisë (Fuchs, 2013)

Ndërsa Beers kur flet për median demokratike dhe të pavarur, ai merret kryesisht me aspektin e saj ekonomik. “Unë” - thotë ai,- “do ta përcaktoja median e pavarur si lajme që nuk iu nënshtrohen presioneve të zakonshme që lidhen me formën dominuese, me çështjet e pronësisë. Këto presione në rritje, siç reflektohen në përmbajtje, përfshijnë përputhjen me status quo-në e perceptuar, në mënyrë që të mos shqetësojnë reklamuesit e kompanive dhe audiencën masive që u është dhënë atyre reklamuesve; dhe kushtimin e burimeve për krijimin e “mjediseve të reklamimit” (duke u përqendruar në tema për të tërhequr reklamuesit që sigurojnë

pjesën më të madhe të të ardhurave për gazetat e mëdha dhe praktikisht të gjitha të ardhurat për televizionin dhe radion)” (Beers, 2006).

Studiues Bob Samuels e ngre diskutimin në një rrafsh tjetër. Ai trajton angazhimin dhe rithemelimin e protestave të nxitura nga mjetet e reja të komunikimit. Samuels është i idesë se teknologjitë e reja të komunikimit në media ndihmuan në nxitjen e protesta spontane që ishin të vështira për tu kontrolluar dhe parashikuar, dhe ky spontanitet shihet si një nga pikat më të forta të lëvizjes protestuese. Askush nuk mund të parashikonte se çfarë do të bënin protestuesit tjetër, sepse as ata nuk e dinin (Samuels, 2011)

Propozimi më interesant që lidhet me demokracinë dhe pjesëmarrjen vjen nga studiuesi Clarence Carson, i cili shprehet se vetë demokracia bazohet në një iluzion. Për Carson “demokracia është një iluzion i lindur në paqartësi, i ushqyer nga një parti politike, i sjellë në pjekuri në konfuzion romantik dhe i vendosur në shërbim të reformës sociale. (Carson, 1965) Por para se të rishikohet kjo çështje shkurtimisht, karakteri i iluzionit duhet të bëhet i qartë. Iluzioni themelor këtu është se Shtetet e Bashkuara, qoftë veçmas siç përfaqësohen nga qeveria e përgjithshme, ose të marra së bashku duke përfshirë qeverinë e shtetit, janë një demokraci. Qeveria e përgjithshme e Shteteve të Bashkuara nuk është një demokraci. Nuk është një demokraci historikisht, etimologjikisht, as në kuptimin në të cilin reformatorët e përdorin fjalën për të justifikuar programet e tyre. Kuptimi themelor i demokracisë është rregulli, ose qeverisja, nga njerëzit. Qeveria, sipas Fjalorit të Kolegjit Amerikan, do të thotë, “drejtimi dhe kufizimi autoritar i ushtrimit të veprimeve të njerëzve në bashkësi, shoqëri dhe shtete; drejtimi i punëve të një shteti, etj.; Sundimi politik dhe administrimi...” Duhet të jetë e qartë se në Shtetet e Bashkuara njerëzit nuk qeverisin. Ata nuk i bëjnë ligjet. Ata nuk i zbatojnë ligjet. Këto funksione kryhen nga ata njerëz në shërbim qeveritar. Asgjë nuk duhet të jetë më e thjeshtë se kjo. (Carson, 1965)

Nëse do ta zbresim në kontekstin Shqiptar, shohim që media sociale ka nxitur protestën, ka rritur reagimin, por nga ana tjetër ka krijuar mekanizma për të mbrojtur vetë liderët politikë duke shtuar mundësitë e propagandimit, duke krijuar ata vetë

mediat e tyre dhe jo pak raste duke eliminuar mediat e sidomos llogaridhënien. Nëse i rikthehemi idesë së profesorit të komunikimit Artan Fuga, por edhe gjithë studiuesve që kanë trajtuar sjelljet e audiencave në mediat e reja, vëmë re se vetë audienca ka sjellje të ndryshme në realitet dhe sjell të tjera në mediat online. Nga ana tjetër demokracia si sistem qeverisës është plotësisht i burokratizuar, dhe në vende që janë akoma në tranzicion mund të themi që jetojmë akoma në iluzionin demokratik.

Demokracia dhe algoritmat

Debatet mbi rolin që kanë mediat e reja në demokraci lidhen në pjesën më të madhe me manipulimin, dezinformimin dhe keqinformimin e publikut. Në punimin e tij “Algoritmat, manipulimi dhe demokracia” (*Algorithms, Manipulation, and Democracy*) studiuesi Thomas Christiano, është i idesë se demokracia kuptohet në raportet që ajo ka me manipulimin. Sipas tij tre dukuri që i shpien audiencat drejtë manipulimit janë: filtrimi (*filtering*), mbinxitja (*hipernudging*) dhe mikro-shënjestrimi (*micro-targeting*). Sipas Christiano, këto tre element “mund të kenë efektin e polarizimit të një elektorati dhe në këtë mënyrë të minojnë potencialin deliberativ të një shoqërie demokratike”. Sipas studiuesve algoritmet mund të përhapin lajme të rreme në të gjithë shoqërinë, duke minuar potencialin epistemik që synohet të ofrojë pjesëmarrja e gjerë në demokraci. (Christiano, 2021)

Sipas studiuesit Cass R. Sunstein, “manipulimi përfshin ndikimin e një personi në një mënyrë që nuk angazhon mjaftueshëm aftësitë racionale të atij personi” (Sunstein, 2016). Duke parë këtë pohim, manipulimi ndodh duke mos i angazhuar aftësitë arsyetuese të një individi ose anëtarit të audiencës. Por sidoqoftë ai, ato aftësi arsyetuese mund të vihen në aksion herëdokur dhe ky lloj manipulimi nuk mund të konsiderohet i mirëfilltë. Duke parë këtë paqartësi mbi manipulimin, Tomas Christiano rëndit tre këndvështrime mbi manipulimin:

- *Manipulimi si arsye nënvlerësuese*: A manipulon B, nëse A ndikon B drejt ndryshimit të mendjes duke bërë diçka që zvogëlon ose përmbys funksionimin

e aftësive racionale të veta. Pra kur njeriu e ka një ide të vetën e cila pasi përballlet me një ide të re, përmbysset.

- *Manipulimi si indiferent ndaj arsyes:* A manipulon B për të besuar p ose për vepruar d kur A ndikon B të besojë p ose të bëjë d me mjete të caktuara dhe A është indiferent nëse B vjen te besimi ose veprimi në një mënyrë të justifikuar.
- *Manipulim i gabuar si përdorimi me dijeni i arsyetimit me të meta:* A manipulon B kur A ndikon B në drejtim të besimit p ose d duke ndikuar B të besojë p ose të bëjë d me anë të një procesi arsyetimi të metë, për të cilin A e di se funksionon sepse B është nuk është në dijeni të defektit në proces, ose nuk është në gjendje ta korrigjojë atë. Këtu duhet të ketë një konflikt qëllimi midis A dhe B, i tillë që pa të metën, B do të shkonte në një drejtim tjetër që shkon kundër qëllimit të A. (Christiano, 2021)

Filtrimi (*filtering*), mbinxitja (*hipernudging*) dhe mikro-shënjestrimi (*micro-targeting*) nuk janë domosdoshmërisht raste të manipulimit objektiv, por ato janë rastet kryesore të manipulimit që studiuesit diskutojnë kur mendojnë për manipulimin algoritmik.

Mbinxitja (*hipernudging*) është një formë shtytjeje që rikonfiguron vazhdimisht shtytjen bazuar në të dhënat që një algoritëm merr nga ju dhe të tjerët dhe përndryshon shtytjen në varësi të informacionit dhe algoritmit në lojë (Christiano, 2021)

Mikro-shënjestrimi (*micro-targeting*) përfshin përdorimin e algoritmeve për të synuar mesazhe për grupe të caktuara personash të cilët do të kishin veçanërisht të ngjarë të zhvendoseshin nga ato mesazhe duke pasur parasysh të gjitha të dhënat e mbledhura rreth asaj nga çfarë do të zhvendoseshin ata dhe të tjerët si ata (Benkler, Faris, & Roberts, 2018). Mikro-shënjestrimi ka thelluar më shumë personalizmin e përmbajtjes duke u bazuar në algoritmet e aplikuara mbi dhënat duke specifikuar se çfarë lloj mesazhi duhet t'i dërgojë një grupi shumë të vogël personash që kanë tiparet përkatëse. (Christiano, 2021)

Duke ndjekur këtë linjë argumentimi, shumë autorë shprehin se mikro-shënjestrimi mund të jetë manipulues në shumë mënyra. Së pari, mund të jetë shumë emocional,

duke shkaktuar trandje ose frikë te anëtarit i audiencës. (Christiano, 2021) Kujtoni kur ju flisni me dikë për një produkt apo shërbim pa patur kurrfarë nxitje dhe sapo futeni në një platformë digjitale përballeni me atë produkt apo shërbim. Kjo lloj mbikëqyrjeje duke u bazuar te të dhënat që platformat marrin nga pajisjet tona, zakonisht ngjall frikë. (Siapera, 2018) Së dyti mikro-shënjestrimi mund të përfshijë gjysmë të vërteta, keqinformim të plotë ose konkluzione të nxituara. Nëpërmjet këtyre elementëve nxitja digjitale shtyn një grup individësh që të dalin e të votojnë ose të përfshihen në aktivitete të tjera politike. (Christiano, 2021)

Të tre dukuritë e përmendura më sipër vijnë si pasojë e mundësive që lejojnë pikërisht algoritmi. Ekzistojnë disa përkufizimi dhe këndvështrimë mbi algoritmin. Një këndvështrim interesant e jep studiuesi medias Nicholas Carah, te libri i tij “Media dhe shoqëria” (Media and Society). Kur përpiqet të shpjegojë algoritmin, ai thotë se algoritmi funksionon pak shumë si paragjykimi i mendjes njerëzore, e cila del në përfundime të shpejta duke u bazuar në shumë pak informacion. Kështu, sipas Carah, edhe algoritmi del në përfundime paraqytuese, ku në shumë raste është përfundim manipulues ose i manipuluar. Sipas tij duke u bazuar te kombinimi i të dhënave janë krijuar tre lloje paragjykimesh

1. *Paragjykimi historik*, ku sistemet algoritmike riprodhojnë format ekzistuese të diskriminimit ose pabarazisë strukturore.
2. *Paragjykimi i grupeve të të dhënave*, ku të dhënat zgjidhen, organizohen dhe etiketohen në mënyra që pasqyrojnë një këndvështrim të caktuar. Për shembull, ku një grup të dhënash imazhesh është etiketuar me terma që denigrojnë njerëzit në bazë të racës, gjinisë ose seksualitetit të tyre.
3. *Paragjykimi algoritmik*, ku proceset e automatizuara të vendimmarrjes optimizohen ose peshohen për të favorizuar rezultate të veçanta. Për shembull, algoritmet e rekomandimit.

Një element tjetër i cili vë në diskutim të madh çështjet e demokracisë në mediat e reja është edhe polarizimi politik. Sipas shumë studiuesve polarizimi politik në sferën digjitale paraqet një sfidë të madhe për shumë demokraci në mbarë botën.

Ata argumentojnë se ekzistojnë tre aspekte kyçe të polarizimit politik: polarizimi ndërveprues (ndërveprimet homofile kundrejt përdoruesve heterofile); polarizimi pozicional (pozicionet e shprehura) polarizimi afektiv – (emocionet dhe qëndrimet e shprehura) (Yarchi, Baden, & Kligler-Vilenchik, 2020).

Në studimin me titull *“Polarizimi në sferën digjitale: Ndër-platforma, një analizë në kohë e polarizimit ndërveprues, pozicional dhe afektiv në mediat sociale”* (Political Polarization on the Digital Sphere: A Cross-platform, Over-time Analysis of Interactional, Positional, and Affective Polarization on Social Media) të kryer nga Moran Yarchi; Christian Baden dhe Neta Kligler-Vilenchik, tregojnë se polarizimi politik në mediat sociale nuk mund të konceptohet si një fenomen i unifikuar, pasi ka dallime të rëndësishme nga platforma në platformë. (Yarchi, Baden, & Kligler-Vilenchik, 2020) Sipas analizës së punimit në Twitter kryesisht mbizotëronin modelet e ndërveprimit homogjen, polarizimi i rënduar pozicional, armiqësia e theksuar ndër-grupore, ndërsa në Facebook u zbulua se ishte platforma më pak homofile për sa i përket ndërveprimeve, pozicioneve dhe emocioneve të shprehura. (Yarchi, Baden, & Kligler-Vilenchik, 2020) Rezultatet e një tjetër punim që lidhet me polarizimin politik në platformave digjitale sugjerojnë se përforcimi politik dhe polarizimi efektiv rriten nga videot politike të zgjedhura nga algoritmi i rekomandimit të YouTube, i cili bazohet në preferencat e kërkimit të pjesëmarrësve. (Cho, Ahmed, Hilbert, Liu, & Luu, 2020) Ky rezultat vjen si pasojë e aftësisë që mediat e reja kanë për të ndërtuar atë që quhet flluska e filtrit.

Ndërmjetësuesit si rrjetet sociale, motorët e kërkimit ose grumbulluesit e lajmeve janë parë si fajtorë për përballjen e përdoruesve të tyre vetëm me përmbajtje të përshtatur për preferencat e tyre personale. Në këtë kontekst, flluska e filtrit është një fjalë e zakonshme e kudogjendur. Vështirë se ndonjë metaforë është bërë aq e njohur sa flluska e filtrit - domethënë “një univers unik informacioni për secilin prej nesh” një term i krijuar për herë të parë nga aktivistja e internetit Eli Pariser. Në librin e tij, Flluska e filtrit: Çfarë fsheh interneti nga ju, Pariser i referohet logjikës së personalizimit të Facebook dhe paralajmëron për ndikimet shoqërore të perspektivave të kufizuara algoritmikisht. (Pariser, 2011)

Përfundime dhe rekomandime

Duke analizuar literaturën dhe konceptet teorike të punimin arrihet në përfundimin se bazuar zhvillimet socio-politike dhe duke ndjekur praktikatat algoritmike mediat e reja po luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një iluzioni mbi demokracinë. Kjo bëhet duke manipuluar audiencat nëpërmjet disa mënyrave.

Së pari nëpërmjet filtrimit të informacionit me anë të programeve algoritmikë, platformat e mediave të reja përcjellin përmbajtje të moderuar te audiencat. Kjo bën që audiencat të trajtohen si treg konsumator dhe jo si qytetarë.

Së dyti, nëpërmjet mbishtytjes (*hipernudging*) të cilën platformat e mediave të reja ofrojnë me anë të reklamave të herëpashershme.

Së treti nëpërmjet mikro-shënjestrimi (*micro-targeting*), i cili përçon informacion të personalizuar te anëtarët e audiencës.

Së katërti, duke ndjekur logjikën e personalizimit, filtrimit, dhe nxitjes së audiencave, mediat e reja kanë ndërtuar flluskave të filtrit. Këto flluska filtri kontribuojnë për të homogjenizuar informacionin e për pasojë edhe idetë mbi realitetin.

Së pesti, si pasojë e flluskave të filtrit, mediat e reja kanë kontribuar në polarizimit politik në sferën digjitale.

Mediat e reja kanë rithemeluar protestën duke i dhënë një karakter tjetër dhe një organizim shumë më të shpejtë se në rastet para saj, siç mund të kuptohet që mediat e reja kanë shtuar mundësin e propagandimit me mesazhe politike nga liderët duke rritur kështu mundësinë e manipulimit dhe rrezikimin e demokracisë.

Në këtë situatë lipset të kuptojmë se lidhjet mes pluralizmit mediatik dhe demokracisë nuk janë në raporte zëvendësuese dhe se lidhja mes tyre sa vjen e pakësohet. Kjo po ashtu lind nevojën që mediat e reja të analizohen dhe të trajtohen në mënyre kritike sidomos aspektet që lidhen me algoritmet dhe demokracinë. Po ashtu lipse të bëhen studime të tjera në këto proces sa komplekse aq edhe të rëndësishme në ditët që po jetojmë.

BIBLIOGRAFIA

Ball-Rockeach, S. J., & DeFleur, M. L. (1976). A DEPENDENCY MODEL OF MASS-MEDIA EFFECTS. *Communication Research*, 1-21.

Beers, D. (2006). The Public Sphere and Online, Independent Journalism. *Canadian Journal of Education*, 109.

Benkler, Y., Faris, R., & Roberts, H. (2018). *Netëork Propaganda: Manipulation, Disinformation, and Radicalization in American Politics*. Oxford, United Kingdom: Oxford Scholarship Online.

Carson, C. (1965). *fee.org*. Gjetur 12 17, 2019, nga Foundation for Economic Educations: <https://fee.org/articles/the-flight-from-reality-12-the-democratic-illusion/>

Cho, J., Ahmed, S., Hilbert, M., Liu, B., & Luu, J. (2020). Do Search Algorithms Endanger Democracy? An Experimental Investigation of Algorithm Effects on Political Polarization. *Journal of Broadcasting & Electronic Media*, 150-172.

Christiano, T. (2021). Algorithms, Manipulation, and Democracy. *Canadian Journal of Philosophy*, 1–16.

Fuchs, C. (2013). In Producing the Internet. Critical perspectives of social media. *Göteborg: Nordicom*, 25.

Fuchs, C. (2018). Në C. Fuchs, *THE PROPAGANDA MODEL TODAY* (f. 71). London: University of Ëestminster Press.

Habermas, J. (1989). *Egalitarianism*. Gjetur 06 12, 2020, nga <http://egalitarianism.no/>: <http://egalitarianism.no/ëp-content/uploads/2014/10/The-Structural-Transformation-of-the-Public-Sphere..pdf>

Lingren, S. (2017). *“Digital Media and Society”*. London: Sage Publications.

Luo, M. M. (2018). INTERNET USE IN CAMBODIA: A MEDIA DEPENDENCY THEORY PERSPECTIVE. *International Journal of Management and Applied Science*, 100-103.

Pariser, E. (2011). *The Filter Bubble: What the Internet Is Hiding from You*. New York, United States: Penguin Press.

Samuels, B. (2011). Facebook, Twitter, YouTube and Democracy. *Academe*, Vol. 97, 33.

Siapera, E. (2018). *Understanding New Media*. London: Sage Pub.

Sparks, C. (1998). *Komunizmi, Kapitalizmi dhe Massmedia*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias.

Sullivan, J. (2019). *Media Audiences: Effects, Users, Institutions, and Power*. London: Sage Publication.

Sunstein, C. R. (2016). *The Ethics of Influence: Government in the Age of Behavioral Science*. Cambridge, United Kingdom: Cambridge University Press.

Yarchi, M., Baden, C., & Kligler-Vilenchik, N. (2020). Political Polarization on the Digital Sphere: A Cross-platform, Over-time Analysis of Interactional, Positional, and Affective Polarization on Social Media. *Political Communication*, 98-139.

Erisa DATJA²

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Abstract

This paper is based on the view of criminal offenses in the field of information and communication technology as one of the most developed and most threatened areas which now permeates almost every aspect of people's lives and as a result it does society most exposed to cybercrime, i.e. crime committed against or through data and computer systems.

In this paper I have tried to address the most important issues and highlights related to the crime committed against data and computer systems and to bring the features of this crime. Analysis of criminal offenses committed in computer systems is one of the most valuable innovations in the field of criminal law as previously criminal offenses committed in this field were very few or previously unverified as well as developments in the field of technology and information is the innovation of recent years.

Keywords: *computer, computer system, cybercrime, computer data, Criminal Code*

² Kolegji Universitar “Bedër”
Departamenti i Drejtësisë,
Email: edatja@beder.edu.al

Abstrakt

Ky punim ka në bazë të tij vështrimin e kryerjes së veprave penale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si një nga fushat më të zhvilluara dhe më të kërcënuara e cila tani më përshkon pothuajse cdo aspekt të jetës së njerezve e si rrjedhojë kjo e bën shoqërinë më të ekspozuar ndaj krimit kibernetik, domethënë krimi i kryer kundër të dhënave dhe sistemeve kompjuterike ose nëpërmjet tyre.

Në këtë punim jam përpjekur të trajtoj çështjet më të rëndësishme dhe pikat kryesore në lidhje me veprën penale të kryer ndaj të dhënave dhe sistemeve kompjuterike dhe për të sjellë veçoritë e kësaj vepre penale. Analiza e veprës penale të kryer në sistemet kompjuterike përbën një nga risitë më me vlerë në fushën e të drejtës penale pasi më parë vepra penale të kryera në këtë fushë ishin shumë të pakëta ose të paverifikuara më parë pasi edhe zhvillimi në fushën e teknologjisë dhe informacionit është risi e viteve të fundit.

Fjalë kyce: *kompjuter, sistem kompjuterik, krim kibernetik, të dhëna kompjuterike, Kod Penal*

Hyrje

Risitë që paraqet kjo fushë shtrojnë nevojën për ndërhyrje të vazhdueshme ndaj sjelljeve kriminale të ndodhura në hapsirën kibernetike, pasi format e konsumimit të veprave penale kibernetike ndryshojnë dukshëm nga format tradicionale të krimit dhe si rrjedhojë, aplikimi i mundëshëm i normave ekzistuese penale ndaj sjelljeve të paligjshme të realizuara nëpërmjet sistemeve kompjuterike do të rezikonte ndjeshëm zhvillimin shoqëror të vendit, sidomos në Shqipëri. Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i teknologjisë, qasja në internet dhe informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Rritja e përdorimit të komunikimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin shoqëror të vendit, por, në të njëjtën kohë, ajo ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe joshtetëror.

Për parandalimin e krimit kibernetik Shqipëria ka ratifikur “Konventën e Budapestit mbi Krimin Kibernetik”, dhe ka përfshirë në Kodin Penal disa vepra penale kibernetike me ligjin nr.10023, datë.27.11.2008 për disa shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me acquis~communitaries e vecanërisht me parashikimet e Konventës.

Me nocionin ‘kriminalitet’ kuptohet tërësia e të gjitha krimeve të kryera në një kohë, hapësirë dhe periudhë të caktuar. Ndryshimi i shoqërisë së sotme filloi me revolucionin agrar, u pasua nga revolucioni industrial dhe arriti deri periudhën e sotme në epokën e revolucionit informatik³. Ndryshimi që solli revolucionin informatik ishte automatizimi i çdo procesi duke e shëndërruar çdo informacion në një kod binar, duke e përpunuar atë dhe duke gjeneruar informacion të ri. Bazuar në format e ndryshme të kriminalitetit në shoqëritë e zhvilluara bashkohore evidentohet një formë e re krimi, ajo në fushën e kibernetikës⁴.

³ 1 Domenico V. (2007), - Krimi i ri i kompjuterave. Evolucioni i fenomenit dhe strategjitë e kontrastit,

⁴ Halili R. (2008), Kriminologjia, Prishtinë, fq. 69.

Krimet kompjuterike janë përkufizuar si:

Vepra penale që kryhen kundër individëve apo grupeve të individëve me qëllim përfitimin e vlerës ekonomike, dëmin e imazhit të viktimës apo shkaktimin e një dëmi fizik ose mendor drejtëpërdrejt ose tërthorazi, duke përdorur teknologjinë modern, ose ndryshe përkufizohet si kryerja e veprimeve me anë të një sistemi të komanduar, ku qëllimi është përfitimi me anë të mashtrimit, thyerjes së sistemeve të sigurisë, shfrytëzimi etj.

Në dallim nga krimet e tjera të njohura, krimet kompjuterike dallojnë pasi ato janë të lehta për tu mësuar se si të përdoren, kërkojnë fare pak burime, por nga burimi i të cilave shkaktohen dëme të rënda dhe të mëdha, mund të kryhen në një juridiksion të caktuar pa qenë aty fizikisht, dhe ajo që është më e spikatur, paligjshmëria e tyre është jo dhe aq e kuptueshme⁵.

Kompjuteri si objekt sulmi

Zhvillimi i teknologjisë informatike ka përcaktuar rolin që kompjuteri ka në zhvillimin dhe funksionimin e shoqërisë bashkëkohore si dhe varësin gjithnjë e më të madhe të shoqërisë ndaj teknologjisë informatike. Në këtë këndvështrim, sistemet kompjuterike dhe kompjuterat bëhen objekt i këtyre sulmeve kibernetike me qëllim ndryshimin e të dhënave apo asgjësimin e tyre. Gjithashtu rëndësia dhe vlera e hardëerit dhe softverit si dhe llojët e ndryshme të të dhënave që gjenden në sistemet kompjuterike, tërheqin mjaftueshëm individë dhe grupe të organizuara kriminale, të cilët tentojnë të komplementojnë ato në mënyrë ilegale⁶.

⁵ Masuda. (1980), "Shoqëria e informacionit si shoqëri post-industriale".

⁶ https://uet.edu.al/images/doktoratura/Aldo_Shkembj.pdf

Kompjuteri si mjet i kryerjes së veprës penale

Një veprimtari e caktuar kriminale, nuk mund të kryhet pa ndihmën e kompjuterit. Përdorimi i tij si mjet për realizimin e veprimeve kriminale në fusha të caktuara, duke përdorur mekanizma të automatizuar për modifikimin dhe manipulim të formave elektronike të vlerave shoqërore, sic janë programet kompjuterike dhe të dhënat të cilat prezantojnë të mirat dhe shërbimet, paratë dhe informatat, mundëson ose lehtëson punën e autorit për realizimin e veprimeve të caktuara kriminale.

Përdorimi i kompjuterit si mjet për kryerjen e krimit mund të bëhet kryesisht për realizimin e formave të krimit kibernetiksi: Keqpërdorimet financiare, krijimin dhe përhapjen e viruseve, vjedhjen e informative nga sistemet kompjuterike.

Veprat penale të parashikuara sipas dispozitave të Kodit Penal Shqiptar

1. Hyrja e paautorizuar kompjuterike

Hyrja e paautorizuar kompjuterike⁷ është një figurë vepre penale që në rrethana të caktuara mund të konkurojë me shkeljen e fshehtësisë së korrespondencës. Në dispozitën përkatëse të Kodit Penal parashikohet se *“Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cënimit të masava të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.*

Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet”.

Përpara se të analizojmë se në çfarë kushtesh vepra penale e pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës, konkuron me veprën penale të hyrjes së paautorizuar kompjuterike, është e nevojshme që të sqarojmë shkurtimisht se çfarë kuptojmë me termin sistem kompjuterik.

⁷ Neni 192/b i Kodit Penal të R.Sh i ndryshuar me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008

Sistemi kompjuterik mund të ndahet në katër komponente. Ato janë:

1. Hardware-i - është njësi themelore fizike e kompjuterit që përdoret për përpunimin dhe për ruajtjen e të dhënave;
2. Sistemi operativ - i cili kontrollon dhe koordinon tërë punën e kompjuterit;
3. Programet - të cilat shërbejnë për të shkruar një tekst, për të kryer llogaritje matematikore, për të komunikuar me kompjuterët tjerë në rrjet etj;
4. Shfrytëzuesit - Shfrytëzues të një kompjuteri mund të jenë njerëzit dhe kompjuterët tjerë. Në rastin kur shfrytëzues të një kompjuteri janë kompjuter të tjerë, kompjuteri i cili ofron shërbime quhet *server* ose shërbyes, ndërsa kompjuteri i cili shfrytëzon shërbimet e kompjuterit tjetër quhet klient.

Shpjegimi i termit të mësipërm ishte i nevojshëm për të kuptuar se në çfarë mënyre hyrja e paautorizuar në një sistem kompjuterik ose në një pjesë të tij mund të shoqërohet me kryerjen e veprimeve që pengojnë ose shkelin fshehtësinë e korrespondencës. Më poshtë do të shpjegojmë se si këto dy vepra penale mund të konkurojnë me njëra tjetrën. Së pari, duhet thënë që objekti i këtyre dy veprave penale është i ndryshëm. Si rrjedhim ato nuk përthithen nga njëra-tjetra por konkurojnë ndërmjet tyre.

Objekti i veprës penale të pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar fshehtësinë e korrespondencës të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale, ndërsa objekt i v.p të hyrjes së paautorizuar kompjuterike janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar sistemet kompjuterike nga ndërhyrjet e paautorizuara të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale.

Shqyrtojmë tashmë rastin kur ndërhyrja e paautorizuar kryhet në një sistem kompjuterik të zotëruar dhe të përdorur nga një operator i rrjetit të komunikimeve elektronike publike ose ofrues i këtyre shërbimeve, nëpërmjet të cilit realizohen komunikimet elektronike publike. Pra, një sistem i tillë shërben për realizimin e

komunikimeve elektronike të të gjithë përdoruesve të tij. Nëse subjekti kriminal siguron në mënyrë të paligjshme aksesin në Hardëerin dhe/ose sitemin operativ të sistemit kompjuterik të sipërpërmendur, nëpërmjet cënimit të masave të sigurimit, (si p.sh duke vjedhur pasëordin) atëhere ai ka mundësi që të kryejë veprime të ndryshme që prekin fshehtësinë e korrespondencës të cilitdo prej përdoruesve të këtij sistemi.

Nëse subjekti pasi ka kryer një hyrje të paautorizuar në Hardëerin ose sistemin operativ të një sistemi kompjuterik të përdorur për realizimin e komunikimeve elektronike publike, kryen veprime të tilla si ndërprerja, vënia nën kontroll, përgjimi i këtyre komunikimeve, ose hapjen dhe leximin e mesazheve të transmetuara nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit, atëhere do të ishim përpara konkurimit të veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës me veprën penale të hyrjes së paautorizuar kompjuterike. Në varësi të cilësisë që ka subjekti që kryen këto veprime, neni 192/b i kodit penal do të konkuronte sipas rastit me neni 123 ose nenin 255 të këtij kodi. Do të kishim konkurim të nenit 192/b me nenin 255 në rastin kur subjekti kriminal është një punonjës i ngarkuar me funksion shtetëror ose në shërbim publik i cili i kryen veprimet në fjalë, gjatë ushtrimit të funksionit ose shërbimit.

2. Falsifikimi kompjuterik

Falsifikimi kompjuterik⁸ është një tjetër figurë veprë penale që mund të konkurojë me atë të pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës.. Me falsifikim kompjuterik do të kuptojmë *futjen, ndryshimin, fshirjen apo heqjen e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtëpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme.*

⁸ Neni 186/a i Kodit Penal të R.Sh i ndryshuar me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008

Marrim në shqyrtim rastin kur objekt i falsifikimit janë të dhënat kompjuterike⁹ që përmbahen në një sistem kompjuterik të përdorur për realizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike publike. Pjesa dërrmuese e këtyre të dhënave ka të bëjë me mesazhet e transmetuara nëpërmjet rrjetit të komunikimit publik, përmbajtjen e komunikimeve që realizohen nëpërmjet këtij rrjeti apo me trafikun e komunikimit. Nëse falsifikimi prek këtë kategori të dhënash kompjuterike, atëhere ai përbën në vetvete edhe një veprim me anë të të cilit mund të pengohet ose shkelet fshehtësia e korrespondencës.

Falsifikimi në këtë rast do të përfshinte kryerjen e veprimeve të tilla si ndryshimin, fshirjen apo heqjen e të dhënave kompjuterike të cilat përfaqësojnë përmbajtjen e një mesazhi ose komunikimi të transmetuar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit. Në këto kushte do të ishim përpara shkeljes së paprekshmërisë së korrespondencës dhe fshehtësisë së saj për shkak se të dhënat kompjuterike të falsifikuara janë të një natyre të tillë që përfshihen në konceptin e korrespondencës, dhe kësaj të fundit, ligjvënësi i ka siguruar një mbrojtje më specifike duke sanksionuar parashikime të posaçme për rastet kur cënohet paprekshmëria ose fshehtësia e saj.

Nga ana tjetër, në nenin 186/a parashikohet se që të jemi përpara veprës penale të falsifikimit kompjuterik është e nevojshme që të ekzistojë qëllimi specifik. Nëse krijimi i të dhënave të rreme nëpërmjet ndryshimit, fshirjes apo heqjes së të dhënave kompjuterike, nuk është bërë me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, nuk mund të kemi konsumim të kësaj vepre penale. Në mungesë të këtij qëllimi veprimet e kryera do të ndëshkoheshin në bazë të nenit 293/b të K.P (*ndërrhyrja në të dhënat kompjuterike*), pasi qëllimi nuk përbën element të domosdoshëm për konsumimin e veprës penale të parashikuar nga kjo dispozitë.

Pra, kemi konkurim të veprës penale të pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës me veprën penale të falsifikimit kompjuterik kur:

⁹ Me të dhëna kompjuterike do të kuptojmë informacionin e përpunuar ose të ruajtur nga kompjuteri. Ky informacion mund të jetë në trajtën e një dokumenti, imazhi, programi, ose llojeve të tjera të të dhënave.

- Objekt i falsifikimit kompjuterik janë të dhënat kompjuterike të cilat përfaqësojnë përmbajtjen e një mesazhi ose komunikimi të transmetuar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit;
- Mesazhit ose komunikimit i është dhënë një përmbajtje e rreme nëpërmjet ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të përmbajtjes origjinale të tij;
- Qëllimi i falsifikatorit ka qenë paraqitja dhe përdorimi si autentike, i përmbajtjes së falsifikuar të mesazhit ose komunikimit.

3. Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Një tjetër figurë vepre penale me të cilën mund të konkurojë neni 123 ose sipas rastit neni 255 i Kodit Penal është ajo e ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike e parashikuar nga neni 293/a i K.P. Sipas kësaj dispozite *dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet*. Linja e mendimit që ndjekim për të argumentuar mundësinë e konkurimit midis veprave penale të sipërpërmendura është e njëjtë.

Në qoftë se dëmtimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar kryhen në lidhje me të dhëna kompjuterike të cilat përfaqësojnë përmbajtjen e një mesazhi ose komunikimi të transmetuar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit, atëhere do të ishim edhe përpara një ndërhyrjeje të padrejtë në korrespondencë.

Ndërhyrja e padrejtë në korrespondencë do të kishte për objekt të dhënat e sipërpërmendura që përmbahen në një sistem kompjuterik të përdorur për realizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike publike. Kuptohet që falsifikimi i kësaj kategorie të dhënash kompjuterike kryhet në sajë të aksesit në një sistem kompjuterik të përdorur për realizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike publike i cili përmban këto të dhëna. Aksesit në këtë sistem mund të jetë i autorizuar ose jo. Në rast se aksesit nuk është i autorizuar, atëhere ky do të përbënte një veprim

që çon edhe në konsumimin e veprës penale të parashikuar nga neni 192/b- *hyrja e paautorizuar kompjuterike*.

4. Ndërhyrja në sistemet kompjuterike

Vepra penale e pengimit dhe shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës mund të konkurojë edhe me veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i K.P- Ndërhyrja në sistemet kompjuterike. Kjo figurë vepre penale kryhet *duke krijuar pengesa serioze dhe të paautorizuara për të cënuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave*.

Edhe këtu arsyetimi që ndiqet është i njëjtë. Nëse kjo vepër penale kryhet në dëm të një sistemi kompjuterik i cili përdoret për mbarëvajtjen e rrjetit të komunikimeve publike dhe për realizimin e këtyre komunikimeve, atëhere mund të jemi edhe përpara konsumimit të v.p të pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës duke qenë se veprimet e subjektit të veprës në këtë rast, dëmtojnë jo vetëm aspektin material të një sistemi kompjuterik, por edhe aspektin funksional të tij.

Krijimi i pengesave serioze që cënojnë funksionimin e një sistemi kompjuterik të tillë, mund të sjellë ndërprerjen, vështirësimin e komunikimeve që realizohen nëpërmjet tij, ashtu sikurse edhe fshirjen apo suprimimin e përmbajtjes së komunikimeve elektronike. Këto janë veprime nëpërmjet të cilave konsumohet sipas rastit vepra penale e parashikuar nga neni 123 ose 255 i K.P (në varësi të cilësisë së subjektit).

Përfundime

Shoqëria në mbarë botën janë të tërhequra ndaj ërfitimeve të mëdha që sjell teknologjia e informacionit dhe komunikimit dhe qeveritë në vendet e zhvilluara po investojnë në këtë fushë. Këto përfitime që i kalojnë shtetit dhe qytetarëve të tij kanë nevojë të mbrohen nga sulmet kibernetike, sepse kanë rëndësi për sigurinë e vendit.

Siguria kibernetike nuk mund të konsiderohet si një problem, i cili prek apo i takon një institucioni, institucioneve shtetërore, sektori privat i qytetarëve. Ai është një problem i cili prek gjithë fushat e jetës dhe shoqërisë. Si e tillë kërkon marrjen e masave të nevojshme të sigurisë nga të gjithë përdoruesit e teknologjisë dhe hapsirës kibernetike.

Strategjitë dhe programet duhet ti përshtaten nevojave dhe gadishmërisë së vendit për ti zbatuar ato, pa shmangur pasqyrimin e nevojave të ardhshme të vendit. Strategjia më e mirë për vendin tonë do të ishte ndërtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike në periudhën kur kërkohet dhe është më e nevojshme.

Objektivat strategjike që duhet të ndiqen për përmbushjen e këtij vizioni janë:

1. Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike
2. Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike
3. Ngritja e njesive të specializuara
4. Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit
5. Krijimi dhe implementimi i kërkesave bazë të sigurisë kibernetike
6. Shtimi i investimeve për rritjen e sigurisë në rrjetet dhe sistemet shtetërore

Modernizimi i legjislationit në fuqi dhe reshikimin periodik të tij për të adresuar sigurinë kibernetike të lidhur me zhvillimet e hapsirës kibernetike të lidhur me zhvillimet e hapësirës kibernetike në Shqipëri dhe harmonizimin me legjislationin ndërkombëtar, me qëllim që ai të ngelet i përshtatshëm dhe efektiv.

Dhe më konkretisht duhet të ndërmerren nisma ligjore,për të nxituar:përdorimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara në transaksionet elektronike,përdorimin e indentifikimit elektronik të sigurtë në shërbimet e qeverisjese elektronike,me qëllimgarantimin e indentitetit në botën virtuale,qoftë ky për personat fizikë dhe ata juridikë,përdorimin sa më të gjerë të certifikatave për faqe interneti dhe web servera për të garantuar indentitetin e sigurt të faqeve të institucioneve publike dhe kompanive të tjera private të cilat ofrojnë shërbime elektronike në bashkëveprim të institucioneve publike ndaj qytetarëve apo ndaj biznesit.

Ndërrmarja e nismave legjislativë që në kodin tonë penal të përfshihet një dispozitë e vecantë për përcaktimin e përgjegjësisë penale ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve,në rastin kur evidentohet shkelja e detyrimeve të tyre për mbrojtjen e sigurisë dhe fshehtësisë së komunikimeve që ata transmetojnë,pasi natyraa e veprimtarisë që kryejnë,operatorët e rrjeteve të komunikimeve si dhe ofruesit e këtyre shërbimeve,u krijuan atyre mundësi të mëdha praktike për të qenë në kontakt me mesazhet ose bisedat e transmetuara nëpërmjet një rrjeti të tillë, duke pasur kështu mundsi që të ndikojnë në destinacionin dhe integritetin e tyre.kjo do tëë thotë që edhe mundësitë për të cënuar paprekshmërin dhe fshehtësinë e korrespondencës nga ana e këtyre subjekteve janë shumë më të mëdha.

BIBLIOGRAFIA

Domenico V. (2007), - Krimi i ri i kompjuterave. Evolucionit i fenomenit dhe strategjitë e kontrastit

Halili R. (2008), Kriminologjia, Prishtinë, fq. 69.

Masuda. (1980), "Shoqëria e informacionit si shoqëri post-industriale".

Investigating Internet Crimes Todd G. Shipley dhe Art Bowker-2014

G. R. G.Nikhita Reddy, "A study of cyber security challenges and its emerging trends on latest technologies," International Journal of Engineering and Technology – UK, 2014.

K. Thakur, M. Qiu, K. Gai, and M. L. Ali, "An Investigation on Cyber Security Threats and Security Models," in 2015 IEEE 2nd International Conference on Cyber Security and Cloud Computing, New York, NY, USA, Nov. 2015, pp. 307–311, doi: 10.1109/CSCloud.2015.71

Neni 192/b i Kodit Penal të R.Sh i ndryshuar me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008

Neni 186/a i Kodit Penal të R.Sh i ndryshuar me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008

https://uet.edu.al/images/doktoratura/Aldo_Shkembj.pdf

Ndikimi i pandemisë Covid-19 mbi të drejtat e njeriut

Abstract

This paper focuses mostly on the general obligation of states under the ECHR to take appropriate measures to protect individuals from the spread of Covid-19 and from suffering its consequences. These obligations arise mainly from Articles 2 which sanction the right to life, and in Article 3 which sanction protection from inhuman and degrading treatment. It also examines how these rights have been affected by measures taken by States to protect life and health, and contains analysis of the extent to which interference with each right can be seen as justified.

While very few cases related to the Covid-19 pandemic have been settled by national courts so far, there is no doubt that pandemic Convention rights issues will reach the tables of national and international judges in the near future. However, the existing case law of the ECHR in relation to epidemiological situations or infectious diseases is limited

For the first time in the history of the Convention, the Covid-19 pandemic made it possible for many Member States to be affected at the same time by the same unusual crisis situation, which affected so many Convention rights. In the pandemic emergency situation, the positive obligations of the States to protect life and health as well as other rights are engaged, while measures such as house arrests, which were implemented by governments in an effort to contain the pandemic and protect health, interfered with many Convention rights. Moreover the national courts and the Strasbourg Court itself were forced to close their doors and postpone hearings and consultations.

Keywords: *pandemic, Covid-19 Strasbourg Court, ECHR, rights, obligations*

¹⁰ Kolegji Universitar “Bedër”
Departamenti i Drejtësisë,
Email: fmarkja@beder.edu.al

Impakti Covid-19 mbi të Drejtën për Jetën

Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm sipas KEDNj-së për të marrë masat e duhura për të mbrojtur individët nga përhapja e Covid-19 dhe shmangien nga infektimi dhe nga vuajtja e pasojave të tij. Këto detyrime dalin kryesisht nga Nenet 2, 3 dhe 8.

Nuk ka dyshim që pandemia ka prekur shumë nga të drejtat dhe liritë e njeriut që mbrohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që ka ngritur një sërë problemesh të vështira ligjore sipas Konventës. Nga pandemia e Covid-19 është hera e parë në historinë e Konventës që shumë prej Shteteve Anëtare janë prekur në të njëjtën kohë nga e njëjta situatë krize të pazakontë, e cila prek kaq shumë të drejta të Konventës.

Pandemia angazhon detyrimet pozitive të shteteve për të mbrojtur jetën dhe shëndetin si dhe të drejta të tjera, ndërkohë që masat e tilla si mbylljet brenda nëpër shtëpi, të cilat u zbatuan nga qeveritë në përpjekje për të përmbajtur pandeminë dhe për të mbrojtur shëndetin, ndërhyjnë tek shumë të drejta të Konventës. Impakti që pati pandemia ndikoi dhe në gjykatat nacionale dhe vetë Gjykata e Strasburgut u desh të mbyllnin dyert dhe të shtynin seancat dëgjimore dhe konsultimet

Siç është përmendur dhe më lart, e drejta për jetën, është një prej dispozitave themelore në Konventë. Është e drejtë e paderogueshme në kohë paqeje, çka do të thotë se Shtetet nuk mund t'i pezullojnë detyrimet e tyre sipas kësaj dispozite gjatë pandemisë së Covid-19. Në bazë të së drejtës për jetën cdo shtet ka detyrime pozitive për të mbrojtur atë. Neni 2 kërkon që Shtetet të përmbahen nga privimi i paligjshëm i jetës, dhe gjithashtu të marrin masa për të mbrojtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre. Detyrimet pozitive të Shteteve në këtë kontekst mund të

marrin forma të ndryshme, përfshirë detyrimet rregullatore dhe detyrimet operacionale.¹¹

Gjatë situatës së pandemisë, Neni 2 u kërkon Shteteve që të krijojnë një kornizë ligjesh dhe rregullash për të mbrojtur jetën. Kurdo që një Shtet merr përsipër, organizon ose autorizon aktivitete të rrezikshme, ai duhet të sigurohet me anë të një sistemi rregullash dhe kontrollesh të mjaftueshme që rreziku që i kanoset jetës nga ndërmarrja e këtyre aktiviteteve të reduktohet në një minimum të arsyeshëm.¹² Kjo përfshin rregullimin e licensimit, ngritjen, operimin, sigurimin dhe mbikqyrjen e aktiviteteve që vlerësohen të jenë në vetvete të rrezikshme, në një mënyrë që i përshtatet tipareve të veçanta të aktivitetit në fjalë. Shtetet duhet ta bëjnë të detyrueshme për të gjitha palët e përfshira që të marrin masa praktike për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve jeta e të cilëve mund mund të rrezikohet nga rreziqet e ngërthyera në aktivitetet e ndërmarrja. Aktivitetet e “organizuara” ose “autorizuara” nga Shteti, të cilat zakonisht vlerësohen të sigurt, tani mund të bëhen vetvetiu të rrezikshme thjesht për shkak se përfshijnë kontaktet me njerëz të tjerë e rrjedhimisht kërcënim për infektim me Covid-19. Kjo përfshin, për shembull, shkuarjen në shkollë, punë, spitale, qendra argëtimi, biblioteka, muze, dyqane, dhe shfrytëzimi i transportit publik.

Gjithashtu Neni 2 kërkon që qeveritë sankionojnë korniza rregullatore për të marrë masat e duhura për shëndetin dhe sigurinë, dhe në këto hapësira futen dhe ndiqen procedura për të parandaluar përhapjen e Covid-19.¹³ Për shembull, një udhërrëfyes dhe rregullore të tilla mund të ofrojnë këshillim se si të sigurohet distancimi social, të kërkojnë vendosjen e xhamave ndarës mes njerëzve kur janë afër njëri-tjetrit, ose detyrimi për mbajtjen e maskave të fytyrës në vende të caktuara, si në transportin publik. Në disa raste të tjera, të cilat varen nga shkalla e rrezikut të kanosur, mund

¹¹ Udhëzimet nga OHCHR, 27 prill, 2020, “Për COVID-19 dhe ndikimi në Të Drejtat e Njeriut”,

¹² Vendimi “Mučibabić k. Serbisë”, 12 korrikut 2016,

¹³ Vendimi “Cevrioğlu k. Turqisë”, 4 tetorit 2016,

të vlerësohet e nevojshme që të mbyllet ose të kufizohet qasja fizike ndaj këtyre vendeve/shërbimeve nëqoftëse nuk mund të ngrihen sisteme që ato të mund të rrinë hapur pa përbërë kërcënim për jetën.

Në kontekstin e shëndetit publik, shteteve u kërkohet të miratojnë rregullore që detyrojnë spitalet, publike ose private, që të marrin masa për mbrojtjen e jetës së pacientëve dhe stafit.¹⁴ Për të siguruar një reagim ndaj Covid-19 në përputhje me Nenin 2, atëherë qeverive duhet t'u kërkohet që të ndryshojnë dhe të përditësojnë rregulloret që qeverisin operimin e spitaleve brenda juridiksioneve të tyre në përpjekje për të mbrojtur jetën e pacientëve dhe stafit nga kërcënimi ndaj jetës prej Covid-19.

Shtetet gjithashtu kanë detyrimin për të marrë masa operacionale parandaluese për të mbrojtur individët nga kërcënime të veçanta ndaj jetës që dalin nga 'situatat e rrezikshme'¹⁵, në kontekst të aktiviteteve private dhe publike, kur Shteti e ka ditur ose, me arsye, duhet ta ketë ditur për kërcënimin .Kjo detyrë shtrihet më tej duke parandaluar vdekjet që ndodhin nga fatkeqësitë industriale, mjedisore dhe natyrore. Praktika gjyqësore në lidhje me sëmundjet ngjitëse është e kufizuar, dhe mbetet të shihet nëse Covid-19 do të hynte brenda përkufizimit të një 'rreziku natyror' apo një kategorie tjetër.

Vështirësia me një pandemi si Covid-19 është që identifikimi i individit ose individëve jeta e të cilëve është në rrezik është pothuaj i pamundur, meqenëse e tërë popullata e një Shteti mund të infektohet. Kjo vështirësi ndikon mbi kritere sic janë kriteri për rrezik real dhe të afërt.¹⁶ Do të ishte e vështirë për cilindo Shtet që ta dijë se cili prej qytetarëve të vet përballat me rrezikun real dhe të afërt të infektimit me Covid-19. Më tej, ata që e kanë marrë Covid-19 e kanë përjetuar në mënyra të ndryshme, ndërkohë që për disa ka qenë virus kërcënues për jetën, të tjerë nuk kanë

¹⁴ Vendimi "Calvelli dhe Ciglio k. Italisë", 17 janarit 2002

¹⁵ Vendimi "Cevrioğlu k. Turqisë", gjykim i 4 tetorit 2016

¹⁶ Vendimi "Calvelli dhe Ciglio k. Italisë", gjykim i 17 janarit 2002

shfaqur fare simptoma. Prandaj, do të ishte edhe më e vështirë të identifikohehin ata për të cilët Covid-19 paraqet rrezik real dhe të afërt për jetë, në mesin e atyre në rrezik real dhe të afërt të infektimit me Covid-19.

Megjithatë, kjo vështirësi mund të barazpeshohet me faktin që ka qenë e mundur të identifikohej grupe njerëzish të cilët janë më shumë ‘në rrezik’ të marrjes së Covid19 ose të cilët janë më të ndjeshëm ndaj efekteve të tij, për shembull të moshuarit ose ata me sëmundje paraekzistuese. Koha dhe natyra e ndërhyrjes nga autoritetet gjithashtu ka rëndësi. Nëqoftëse identifikohet një grup posaçërisht i ndjeshëm ose në rrezik, Shteteve mund t’u duhet që të marrin masa pozitive për të mbrojtur njerëzit në këtë grup para se të mund të bëhen ankesa individuale ose kërkesa për ndihmë.

Përsa i përket fushës së vlerësimit, janë disa prej faktorëve që lënë të kuptohet se me gjasë Shteteve do t’u lejohet hapësirë e gjerë vlerësimi në lidhje me masat operacionale që ato zgjedhin për të parandaluar vdekjet si rezultat i Covid-19. Shumë prej rasteve të mëparshme në të cilat është gjetur shkelje e detyrës operacionale sipas Nenit 2 kanë lidhje me ngjarje diskrete, rreth të cilave Shteti ka pasur dijeni të qartë dhe ka qenë i paralajmëruar. Natyra vazhdimisht e ndryshueshme e pandemisë Covid-19, që ka të bëjë me daljen e një virusi të ri, e bën më kompleks rrezikun ndaj të cilit duhet reaguari. Njohuritë shkencore dhe të kuptuarit e shkaqeve dhe impaktit të Covid-19 janë ende në zhvillim e sipër. Në fillim të pandemisë, kishte shumë pak studime relevante për t’u konsultuar gjatë procesit të vendimmarrjes se si t’i bëhej ballë situatës. Ato studime që ishin në dispozicion, ose ato që kanë dalë prej atëherë, jo domosdoshmërisht kanë identifikuar një reagim definitiv që mund të thuhet se qeveritë duhet ta kishin ndërmarrë dhe i cili do t’i kishte vënë ato në pajtueshmëri me detyrimet nga Neni 2.

Megjithatë, edhe në kontekst të fatkeqësive mjedisore që Shtetet nuk i kontrollojnë dot, Gjykata ka vendosur që Shtetet kanë detyrimin që të marrin masa operacionale

parandaluese për të fuqizuar kapacitetin e tyre për të trajtuar natyrën e papritur dhe të dhunshme të dukurive të tilla natyrore.¹⁷ Natyra e papritur dhe e paparashikueshme e pandemisë mund të nënkuptojë që Shtetet do të kishin hapësirë më të gjerë vlerësimi sa i përket mënyrës se si reagojnë ndaj saj, por nuk është arsye për të sugjeruar se ato nuk kanë fare detyrime operationale sipas Nenit 2. Prandaj detyrimet operationale të nisura prej janarit 2020 e më tej mund të përfshijnë një detyrim për të porositur paraprakisht pajisje mbrojtëse personale dhe ventilatorë, për të siguruar pajisje mbrojtëse për punonjësit ose për të imponuar mbylljet brenda apo masa të distancimit social, duke marrë parasysh këshillat shkencore të dhëna në atë kohë dhe duke vepruar në mënyrë të kohshme.

Për të konstatuar shkelje të detyrimit pozitiv operacional sipas Nenit 2 po ashtu është e nevojshme të përcaktohet lidhja shkakësore mes dështimit të shtetit për të marrë masa parandaluese dhe vdekjes së një personi. Mund të jetë e vështirë të identifikohet nëse saktësisht, vdekja e një personi të infektuar me Covid mund të ishte shmangur nëse Shteti do ta kishte marrë masën parandaluese të cilën ka dështuar ta marrë.

Ndërkohë që veprimet ose mosveprimet e autoriteteve në fushën e politikave të kujdesit shëndetësor mund të angazhojnë përgjegjësinë si pjesë e detyrimeve rregullatore nga Neni 2, gabimet në gjykim ose ‘thjesht’ neglizhenca mjekësore nga ana e stafit mjekësor nuk përbëjnë shkelje të Nenit 2. Sipas Nenit 2, Shteti duhet të miratojë dispozitat e duhura për të siguruar standarde të larta profesionale për profesionistët shëndetësorë dhe mbrojtjen e jetës së pacientëve, por koordinimi i pakujdesshëm në trajtimin e një pacienti të dhënë përgjithësisht është i pamjaftueshëm për të qenë shkelje e Nenit 2. Gjykata megjithatë ka vendosur se mund të dalin çështje sipas Nenit 2 kur tregohet se autoritetet kanë vënë në rrezik jetën e një individi duke i mohuar qasjen në kujdes shëndetësor, gjë që ato janë zotuar ta vënë në dispozicion për tërë popullatën.

¹⁷ Vendimi “Stoyanovi k. Bullgarisë”, 9 nëntorit 2010

Përndryshe, në kontekst të shëndetësisë, detyrimet operacionale pozitive për të mbrojtur jetën dalin vetëm në rrethana të pazakonta: i) Kur jeta ‘me dijeni vihet në rrezik përmes mohimit të dhenies së ndihmës mjeksore; dhe ii) kur ‘mos-funksionimi sistematik ose strukturor i shërbimeve spitalore rezultojnë me privimin e pacientit nga marrja e ndihmës mjeksore emergjente, dhe autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kenë ditur që ekziston ky rrezik dhe kanë dështuar në marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar konkretizimin e atij rreziku...’.¹⁸

Prandaj, mund të ngrihen akuza potenciale kundër Shtetit për shkelje të Nenit 2 në një çështje individuale, në kontekstin e shëndetësisë, nëqoftëse një person vdes për shkak se nuk i është dhënë ndihma emergjente, në kontekstin e Covid-19 kjo mund t’i referohet ndihmes me oksigjen, për shembull. Megjithatë, do të duhet të demonstrohet që mohimi ose vonesa e ndihmës në këtë trajtim ka rezultuar ose nga neglizhenca e rëndë mjekësore ose nga një dështim më i gjerë sistemik ose strukturor nga ana e shtetit për të ndërmarrë masat e nevojshme për të parandaluar konkretizimin e rrezikut.¹⁹

Në përgjithësi, detyrimet rregullatore të Shtetit për të mbrojtur jetën, duhet të shtojë dhe masat për mbrojtjen e shëndetit mendor, duke marrë parasysh rrezikun e shtuar të ideve për vetëlëndim dhe vetëvrasje të shkaktuar nga përkeqësimi i shëndetit mendor gjatë pandemisë. Kjo mund të përfshijë përshtatjen e kornizës së ligjeve që rregullojnë qasjen në shërbime mbështetëse për shëndetin mendor për t’u siguruar që mbështetja të vazhdojë të jetë në dispozicion për ata që janë të izoluar ose në karantinë (për shembull përshtatja e shërbimeve në mënyrë që ato të ofronen përmes telefonit) dhe shërbimet mbështetëse të vihen në dispozicion të gjerë.

Në disa rrethana të caktuara, Neni 2 mund të nënkuptojë detyrimin pozitiv nga ana e autoriteteve për të marrë masa parandaluese për të mbrojtur individët nga vetvetja.

¹⁸ Rekomandim I KE, 7 prill 2020, “Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19”

¹⁹ Gjykimi i Dhomës së Madhe, 19 dhjetorit 2017, “Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë”,

Personat me paaftësi mendore konsiderohen se përbëjnë një grup posaçërisht të ndjeshëm që kërkon mbrojtje nga vetëlëndimi. Për të ekzistuar detyrimi operacional kur rreziku ndaj një personi rrjedh nga vetëlëndimi, duhet të konstatohet që:

- i) autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kenë ditur në atë kohë për ekzistencën e një rreziku real dhe të afërt për jetën e individit të identifikuar; dhe
- ii) nëse po, ato kanë dështuar në marrjen e masave brenda fushëveprimit të fuqive të tyre të cilat, duke gjykuar me arsye, mund të jenë pritur që ta shmangin atë rrezik.

Impakti Covid-19 mbi të drejtën për Ndalimin e Torturës

Neni 3 i Konventës është absolut në ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues, është e drejtë e paderogueshme, dhe nuk lejohen ndërhyrje te kjo e drejtë.²⁰ Vuajtja dhe sëmundja mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues brenda fushëveprimit të Nenit 3 të Konventës nëqoftëse ato arrijnë një nivel të caktuar rreptësie. Nuk ka rregulla strikte për të përkufizuar saktësisht se çfarë lloj trajtimi e përmbush këtë kriter të kërkuar rreptësie, dhe përcaktimi i kësaj çështjeje mund të varet nga të gjitha rrethanat e një rasti të dhënë dhe, në disa raste, nga seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës.

Megjithatë, në përgjithësi, trajtimi vlerësohet çnjerëzor nëse shkakton vuajtje fizike ose mendore, dhe vlerësohet degradues nëse provokon ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti të atilla që mund të poshtërojnë dhe të ulin një person, e mbase edhe të thyejnë rezistencën e tij/saj fizike apo morale.

Neni 3 nuk i imponon Shtetit detyrimin për të ofruar një nivel të përgjithshëm kujdesi mjekësor popullatës së përgjithshme për të parandaluar vuajtjet ndaj popullit, por kërkon që Shteti t'u ofrojë ndihmë mjekësore atyre për të cilët ai merr

²⁰ Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese

përgjegjësi, për shembull personat e privuar nga liria. Ekziston rreziku që ata që ndodhen në institucione me shumë banorë siç janë shtëpitë/ azilet e pleqve dhe jetimoret, spitalet dhe shkollat me konvikt për fëmijët me nevoja të veçanta) mund të kenë më shumë gjasa të infektohen nga Covid-19, si rezultat i kushteve më të ngjeshura në të cilat ndodhen.

Ndërkohë që Shtetet janë të detyruara të parandalojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në qendra paraburgimi, ato po ashtu duhet të sigurohen që masat mbrojtëse që zbatohen për të parandaluar përhapjen e Covid-19 në vetvete të mos përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues. Për shembull, vënia në izolim e të burgosurve, mbyllja nga brenda e institucioneve siç janë shtëpitë e kujdesit ose të kërkuarit që individët të karantinohen për periudha të gjata kohore mund t'i mbrojë njerëzit nga Covid-19 por njëkohësisht mund të ndikojë edhe tek shëndeti i tyre mendor në shkallë të atillë që të angazhohet Neni 3 në këtë aspekt.

Në nenin 3 caktohet detyrimi mbi Shtetin që të mbrojë në mënyrë të përshtatshme shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve për të cilët Shteti merr përsipër përgjegjësinë. Kjo përfshin ata që mbahen në burgje, në qendra paraburgimi dhe në spitale psikiatrike, si dhe ata që banojnë në shtëpitë e kujdesit. Në kontekst të pandemisë Covid-19, këtu po ashtu do të përfshiheshin edhe ata që u kërkohet të karantinohen ose të qëndrojnë të mbyllur brenda në shkallë të atillë që kufizimi i lëvizjeve të tyre të përbëjë privim të lirisë. Standardi i kujdesit ofruar atyre që ndodhen në paraburgim duhet të jetë në përputhje me dinjitetin njerëzor të të paraburgosurit. Kjo do të thotë ofrimi i trajtimit mjekësor dhe kushteve të paraburgimit të cilat janë të mjaftueshme, dhe të cilat përputhen me nevojat e veçanta të një të paraburgosuri, përfshirë natyrën e gjendjes shëndetësore, moshën, seksin, dhe çdo dobësi tjetër²¹.

Vetëm fakti që një i paraburgosur është vizituar nga mjeku dhe i është dhënë receta për trajtim mjekësor nuk do të thotë domosdoshmërisht që kujdesi ka qenë i

²¹ Aisling Reidy, Manualë për të drejtat e njeriut, Nr. 6, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

mjaftueshëm sipas Nenit 3. Autoritetet nacionale duhet të sigurohen që diagnoza të dizajnuara sipas natyrës së sëmundjes së personit. Për shembull, autoriteteve të Shtetit mund t'u kërkohet që të organizojnë kujdesin vijues sistematik, ose strategji terapeutike gjithëpërfshirëse me qëllim të shërimit të pacientit, ose të paktën të evitimit të përkeqësimit të sëmundjes së tij.

Trajtimi mjekësor i ofruar duhet të jetë në nivel të krahasueshëm me atë që autoritetet e Shtetit janë zotuar t'i ofrojnë popullatës në tërësi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se çdo personi të ndaluar duhet t'i ofrohet niveli i trajtimit mjekësor që është në dispozicion në institucionet shëndetësore më të mira jashtë burgut. Gjykata ka rezervuar fleksibilitetin për të përcaktuar standardin e kujdesit shëndetësor të kërkuar sipas Nenit 3 me qasjen 'sipas rastit', duke marrë parasysh "kërkesat praktike të burgimit" dhe nevojën për të vlerësuar prioritetet konkurruese gjatë alokimit të burimeve të Shtetit²². Gjykata po ashtu shqyrton nëse autoritetet kanë ndjekur këshillat dhe rekomandimet mjekësore që u janë bërë të ditura rreth mënyrës se si duhet përkujdesur për një të person të mbajtur.

Gjykata ka theksuar që përhapja e sëmundjeve të transmetueshme duhet të jetë shqetësim shëndetësor publik, sidomos në ambientet e burgut. Prandaj kërkesat ndaj Shteteve në lidhje me shëndetin e atyre për të cilët Shtetet marrin përgjegjësi mund të dallojnë varësisht nga fakti nëse kanë të bëjnë ose jo me një sëmundje që është e transmetueshme. Neni 3 u cakton Shteteve detyrimin për të ndërmarrë masa legislative dhe administrative për të shfarosur ose parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në vendet ku mbahen njerëzit të ndaluar/burgosur, ku kërcënimi ndaj shëndetit që kanoset nga sëmundja do të shkaktonte një nivel vuajtjeje aq të rreptë sa të hyjë brenda fushëveprimit të Neneve 2 ose 3²³. Masat mund të përfshijnë futjen e një sistemi të kontrollimit para hyrjes në burg.

²² Debra Long, (2002), Udhëzues për Jurisprudencë mbi Torturat dhe Keqtrajtimet Cnjerzore dhe Degraduere, neni 3 KEDNJ

²³ Vendimi "M. Özel dhe të Tjerë k. Turqisë", gjykim i 17 nëntorit 2005

Kërkesa për të siguruar diagnozën dhe dhënien e trajtim të menjëherëshëm po ashtu do të jetë më e madhe. Kërkesat në praktikën gjyqësore për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në vendet ku mbahen njerëzit e burgosur janë shtuar shumë në kontekst të parandalimit të përhapjes së virusit HIV, tuberkulozit dhe hepatitit. Megjithatë, detyrimet që kanë dalë më përpara theksohen në Deklaratën e parimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Degradues në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekst të pandemisë Covid-19. Deklarata e Parimeve e CPT-së rithekson nevojën për t'i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave specifike të personave të ndaluar e posaçërisht grupeve të ndjeshme dhe/ose grupeve në rrezik, siç janë të moshuarit dhe personat me sëmundje ekzistuese. Autoritetet këshillohen të garantojnë kontrollimin për Covid-19 dhe të sigurojnë qasje në repartet e kujdesit intensiv ose transferim në spitalet ku lind nevoja.

Distancimi social, izolimi mjekësor dhe izolimi i vetmuar në burg

Burgosja e një kërkuesi që ka sëmundje të rëndë dhe tepër ngjitëse në një qeli bashkë me të tjerë mund të përbëjë shkelje të Nenit 3, por fakti që personat e mbajtur që janë HIV-pozitiv kanë përdorur të njëjtat pajisje mjekësore, sanitare, ushqimore dhe të tjera së bashku me të burgosurit e tjerë më përpara nuk ka ngritur çështje nga Neni 3²⁴. Megjithatë, faktet e këtyre çështjeve mund të dallohen nga situata e pandemisë Covid-19. Gjykata ka theksuar faktin se kërkuesit nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj rrezikut real të infeksionit, administrata e burgut i kishte identifikuar mënyrat se si mund të transmetohet virusi HIV dhe kishte marrë hapa për parandalimin e ndodhjes së këtyre veprimeve. Në çështje të tjera lidhru me sigurinë e programeve për shkëmbimin e shiringave, faktorët relevantë përfshinin mungesën e udhëzimeve specifike nga CPT në lidhje me këtë çështje dhe fakti që rreziku i infeksionit kryesisht vinte nga sjellja e vetë të burgosurve.

²⁴ Aisling Reidy, Manual për të drejtat e njeriut, Nr. 6, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Ndryshe nga virusi HIV, Covid-19 mund të përhapet me anë të kontaktit të afërt personal, përfshirë përdorimi i përbashkët i pajisjeve mjekësore, sanitare, ushqimore dhe të tjera. Më tej, ishte e nevojshme dhe e këshillueshme që të gjitha autoritetet të përdornin metoda alternative ndaj privimit të lirisë për të reduktuar stërmbushjen e instituconeve dhe burgjeve. Përpos kësaj situata pandemike ka bërë që shtet të marrin dhe masa sic janë: ulja e dënimeve, lirimi i hershëm dhe lirimi me kusht, dhënia e dënimeve alternative, rivlerësimi i nevojës për të vazhduar mbajtjen e pavullnetshme të pacientëve të psikiatrisë, ku është me vend, dhe përmbajtje në maksimum nga paraburgimi i migrantëve. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut gjithashtu u ka bërë thirrje Shteteve që të lirojnë njerëzit nga paraburgimi i imigracionit në maksimumin e mundshëm për të mbrojtur të drejtat e atyre që janë të privuar nga liria për shkak të përhapjes së Covid-19.

Kur lirimi nga paraburgimi nuk vlerësohet si i mundur ose i përshtatshëm, Shtetet u duhet të sigurohen që të jetë e mundur që një person që del pozitiv me Covid-19 të izolohet larg të mbajturve/burgosurve të tjerë në kushte të pajtueshme me Nenin 3. Izolimi mjekësor, ose ndalimi i kontaktit me të burgosurit e tjerë për arsye sigurie, disiplinore, ose mbrojtëse, nuk shkel automatikisht Nenin 3. Nëse këto masa hyjnë brenda kufijve të Nenit 3, varet nga kushtet e veçanta, rreptësia e masës, kohëzgjatja e saj, objektivi i synuar dhe efektet e saj mbi personin në fjalë.

Megjithatë, izolimi total social, mund të shkatërrojë personalitetin e individit dhe përbën një formë të trajtimit çnjerëzor i cili nuk mund të justifikohet nga kriteret e sigurisë apo ndonjë arsye tjetër. Izolimi i, edhe në rastet kur është vetëm relativ, duhet të bazohet mbi arsye të vërteta, të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme pasi të jenë shqyrtuar alternativat e tjera. Vendosja në izolim duhet të marrë parasysh edhe gjendjen shëndetësore të personit në fjalë, përfshirë shëndetin e tij mendor.

Mund të jetë legjitime që të burgosurit të transferohen në një krah të ndarë të burgut ose në spitalin e burgut në mënyrë që t'u ofrohet një shkallë më e lartë rehatie, ushqim më i mirë, periudha më të gjata ushtrimesh, mbikqyrje e rregullt e trajtimit

të tyre mjekësor, dhe mbrojtje kundër sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 3 vetëm dhe i marrë së bashku me Nenin 14 aty ku të burgosurit HIV-pozitiv ishin vendosur në izolim për këto arsye, por ku gjendja e tyre me HIV nuk ishte zhvilluar në AIDS dhe nuk kishte rrezik që ata t'ua transmetonin virusin HIV të burgosurve të tjerë²⁵. Prandaj, izolimi nuk duhet caktuar si masë paraprake ndaj atyre që nuk dyshohen ta kenë marrë virusin.

Kur Shtetet e pikasin që ka raste në të cilat përdorimi i izolimit në qendra burgimi është i nevojshëm për arsye mjekësore, për të garantuar pajtueshmërinë me Nenin 3, Shtetet duhet:

- a. Të kufizojnë izolimin për arsye mjekësore të të burgosurve që janë të infektuar ose që dyshohet se janë infektuar me Covid-19 për të parandaluar që ta përhapin tek të tjerët.
- b. Ta përdorin izolimin mjekësor vetëm si zgjidhje të fundit pasi të kenë marrë në konsideratë nëse janë me vend alternativa të tjera, siç është lirim.
- c. Të rishqyrtojnë rregullisht nevojshmërinë e vazhduar të izolimit, duke marrë parasysh impaktin në shëndetin mendor të personit dhe nëse ai/ajo vazhdon të dalë pozitiv në testin për Covid-19.
- d. Të kompensojnë kufizimet e kontakteve me botën e jashtme, përfshirë vizitat, duke shtuar qasjen në mënyrat alternative të komunikimit.
- e. Në rastet e izolimit ose vendosjes në karantinë të një personi të mbajtur i cili është i infektuar ose dyshohet se është infektuar nga virusi, personi në fjalë duhet të ketë kontakte njerëzore kuptimplote çdo ditë.
- f. Të ofrohet mbështetje e shtuar psikologjike.

²⁵ Vendimi Korobov dhe të Tjerë k. Rusisë, gjykim i 27 marsit 2008

Ekstradimi

Neni 3 u vë shteteve detyrimin për të mos ekstraduar një person drejt një vendi ku janë treguar arsye për të besuar se personi në fjalë, po të ekstradohet, do të përballët me rrezikun real të trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 në vendin pritës. Për shembull, në rastet që personi do t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi, ose kushteve të paraburgimit që janë në shkelje të kriterëve të përcaktuara në seksionin (a) lart, përfshirë kushtet e paraburgimit që janë të papërshtatshme për dobësitë specifike të individit në fjalë.

Gjykata vendosi për impaktin e pandemisë Covid-19 mbi çështjen nëse do të ekzistonte rreziku real i shkeljes së Nenit 3 për shkak të kushteve të paraburgimit me të cilat do të përballej një individ po të ekstradohej në Shtetet e Bashkuara, në një çështje ekstradimi para Gjykatës në lidhje me një burrë gjashtëdhjetëvjeçar me “disa sëmundje”, përfshirë diabet dhe azma. Vendimi i Gjykatës në këtë çështje do të ketë implikime në lidhje e impaktin e Covid-19 mbi kushtet e paraburgimit në sistemet e burgut përtej kontekstit të ekstradimit, meqenëse vlerësimi nëse është plotësuar kriteri i nivelit minimal të rreptësisë për qëllime të Nenit 3 është i njëjti pavarësisht nëse konteksti është vendas apo ekstraterritorial.

PËRFUNDIME

Ndikime nga Pandemia Covid 19 ka pasur në nenin 2 dhe 3 të KEDNJ-së. Pandemia angazhon detyrimet pozitive të Shteteve për të mbrojtur jetën dhe shëndetin si dhe të drejta të tjera, ndërkohë që masat e tilla si mbylljet brenda nëpër shtëpi, të cilat u zbatuan nga qeveritë në përpjekje për të përmbajtur pandeminë dhe për të mbrojtur shëndetin, ndërhynë tek shumë të drejta të Konventës

Në bazë të së drejtës për jetën cdo shtet ka detyrime pozitive për të mbrojtur atë. Neni 2 kërkon që Shtetet të përmbahen nga privimi i paligjshëm i jetës, dhe

gjithashtu të marrin masa për të mbrojtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre. Detyrimet pozitive të Shteteve në këtë kontekst mund të marrin forma të ndryshme, përfshirë detyrimet rregullatore dhe detyrimet operacionale

Neni 3 u cakton shteteve detyrimin për të ndërmarrë masa legislative dhe administrative për të ndaluar ose parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në vëndë si burgje dhe spitale, ku kërcënimi ndaj shëndetit që kanoset nga sëmundja do të shkaktonte një nivel vuajtjeje aq të rreptë sa të hyjë brenda fushëveprimit të Neneve 2 ose 3

BIBLIOGRAFIA

LIGJE DHE KONVENTA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016

Ligji Nr.8137, datë 31.7.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”

Ligji Nr.8577 “Për Gjykatën Kushtetuese lidhur me organizimin dhe funksionimin e saj.”

Rregullat e Gjykatës, 2 Qershor 2021, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Udhëzimet nga OHCHR, 27 prill, 2020, “Për COVID-19 dhe ndikimi në Të Drejtat e Njeriut”

LIBRA

Shaw, N. Malcolm (2016) “International law” 7th edn Cambridge University Press,

Arben Puto (2002) “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në krahasim me Kushtetutën e Shqipërisë” Albin, Tiranë

Elezi. I., Kaçupi. S., Haxhia.M. (2014), “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Botimet “Kumi”, Tiranë

Bashkimi Europian: Philippe Samyn, Valle, Happold, “Këshilli Bashkimi Europian”, 2018

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Shtator 2020, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Një instrument i gjallë

Manuali “Drejt praktikës: si të përdorim jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në nivel vendas”- Ledi Bianku, Tiranë 2020

Klaus-Diter Borçard, (2010), ABC-ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian

Debra Long ,(2002), Udhëzues për Jurisprudencë mbi Torturat dhe Keqtrajtimet Cnjerezore dhe Dregraduese, neni 3 KEDNJ

Aisling Reidy, Manualë për të drejtat e njeriut, Nr. 6, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Vendime të huaja

Vendimi “Egmez v. Cyprus”, nr. 30873/96.

Vendimi “Labit k. Irlandës”, nr. 26772/95, 2000.

Vendimi “Selmouni k. Francës”, nr. 25803/94, 1999.

Vendimi “Mooren kundër Gjermanisë”, nr.11364/03, 2009.

Vendimi Mučibabić k. Serbisë, gjykimi i 12 korrikut 2016

Vendimi “Cevrioğlu k. Turqisë”, gjykim i 4 tetorit 2016

Vendimi “Calvelli dhe Ciglio k. Italisë”, gjykim i 17 janarit 2002

Genti KRUJA²⁶

Interfaith Dialogue in Albania as a Model of Interreligious Harmony

Abstract

